

Врз основа на член 55 став 1 од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Сл. весник на РМ” бр. 58/00, 44/02 и 82/08) и член 25 од Законот за основно образование („Сл. весник на РМ” бр. 103/08), министерот за образование и наука донесе наставна програма по предметот *албански јазик* за VII одделение на основното осумгодишно образование, односно за VIII одделение за деветгодишното основно образование.

**PROGRAMI  
MËSIMOR**



**MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT**

**GJUHË SHQIPE**

Shkup, nëntor 2008

**ARSIMI FILLOR**

**VËREJTJE:**

Në bazë të dinamikës për aplikimin e edukimit dhe arsimit fillor nëntëvjeçar programi mësimor për nxënësit e klasës së VII të arsimit fillor tetëvjeçar në vitin shkollor 2009/10 është ekuivalent me programin mësimor për klasën e VIII në arsimin fillor nëntëvjeçar.

# 1. QËLLIMET E MËSIMIT TË GJUHËS SHQIPE NË KLASËN VIII

## **Nxënësit:**

- ta përvetësojnë drejtshqiptimin dhe drejtshkrimin e tingujve të Gjuhës shqipe;
- të aftësohen t'i përdorin drejt shenjat e pikësimit dhe ta njohin funksionin e tyre;
- ta përvetësojnë funksionin e emrit në fjali;
- t'i përdorin drejt mbiemrat dhe përemrat pronorë me emrat e gjinisë mashkullore, në shumës, tema e të cilëve del me - e;
- t'i përdorin drejt përemrat pronorë në bashkëvajtje me emrin nëpër rasi, në numrin njëjës dhe në shumës;
- ta dallojnë përemrin pyetës dhe të pacaktuar: veçoritë gramatikore, funksionet si dhe drejtshkrimin e tyre;
- t'i njohin format, kuptimin dhe përdorimin e numërorëve;
- ta përvetësojnë zgjedhimin e foljeve (të tri zgjedhimet);
- t'i dallojnë foljet të cilat kanë mundësi të përdoren me kundrinë të drejtë dhe me kundrinë të zhdrejtë;
- të dallojnë temën, rrënjën, mbaresat, kohët e thjeshta dhe të përbëra të foljes;
- t'i përdorin drejt foljet në mënyrën lidhore me foljet modale ose gjysmëmodale...;
- t'i dallojnë llojet, vendin, rolin e rrethorëve dhe funksionin e tyre si gjymtyrë të dyta të fjalisë;
- të njihen me funksionin e përcaktorit në fjali, si dhe me tiparet e përcaktorit (të veçuar dhe të paveçuar);
- të njihen me funksionin e formave të pashtjelluara të foljes;
- të njihen me ndajshkrimin e veçuar dhe të paveçuar si gjymtyrë e dytë e fjalisë...;
- të aftësohen ta bëjnë dallimin mes fjalisë së thjeshtë dhe fjalisë së përbërë me bashkërenditje dhe me nënrenditje;
- të aftësohen t'i përdorin lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse në fjalitë e përbëra...;
- të bëjnë dallimin mes llojeve të ndryshme të krijimtarisë letrare në vargje...;
- t'i njohin karakteristikat e krijimeve epiko-lirike;
- t'i dallojnë dhe të aftësohen t'i përdorin figurat letrare: simbolin, gradacionin, ironinë...;
- të aftësohen të komunikojnë lirshëm me veprat e gjinisë epike dhe të dallojnë llojet e ndryshme të romanit...;
- t'i vërejnë në mënyrë të pavarur elementet e strukturës së veprës dramatike;
- të dallojnë dramën (në kuptimin e ngushtë të fjalës) nga monodrama dhe nga llojet tjera...;
- të aftësohen të përshkruajnë, të tregojnë e të ritregojnë ngjarje të vërteta ose të imagjinuara duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse;
- të thellojnë aftësitë për të përshkruar peizazhe, monumente kulture dhe personazhë letrarë...;
- të aftësohen të shkruajnë procesverbal;
- të njihen me filmin artistik dhe me llojet e tij;
- të aftësohen t'i dallojnë veçoritë e filmit artistik;

- të aftësohen të krahasojnë filmin artistik me një vepër letrare...
- të njihen me llojet e emisioneve të ndryshme televizive;
- të bëjnë dallimin mes emisioneve televizive dhe atyre të radios...

## 2. QËLLIMET KONKRETE

FUSHA PROGRAMORE: <b>GJUHË</b> (50 orë)			
Objektivat	Përmbajtja	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
<b>Kapitulli I:</b> Gjuha e folur dhe gjuha e shkruar			
<b>Nxënësit:</b> - të aftësohen për drejtshqiptimin dhe drejtshkrimin e tingujve të gjuhës shqipe; - t'i shqiptojnë mirë zanoret: <b>i, y</b> dhe bashkëtingëlloret <b>r, rr.</b>	- Zanoret dhe bashkëtingëlloret	- Tingujt (fonemat) dhe shkronjat	- Lexohen tekste të zgjedhura për të ushtruar drejtshqiptimin e tingujve dhe për të përvetësuar theksin dhe intonacionin e duhur.
- të aftësohen t'i ndajnë fjalët në rrokje; - të njihen me theksin dhe intonacionin (me rëndësinë e tyre gjatë procesit të komunikimit).	- Ndarja e fjalëve në rrokje - Theksi dhe intonacioni	- Rrokja - Theksi - Intonacioni	- Lexohen tekste të shkruara në fletushka me qëllim të përvetësimit sa më të mirë të drejtshqiptimit dhe përdorimit të drejtë të shenjave të pikësimit. Kjo arrihet me forma të kombinuara mësimore...
- ta njohin funksionin e shenjave të pikësimit dhe t'i përdorin drejt ato.	- Shenjat e pikësimit	- Pika, presja, dypikëshi..., pikëpyetja dhe pikëçuditja	- Ushtrime për t'i përdorur drejt shenjat e pikësimit në fund të fjalive...
<b>Kapitulli II:</b> Klasat e fjalëve			
- të njihen me funksionin e emrit si njësi morfosintaksore në fjali - ta kuptojnë drejt njësinë morfologjike në funksion të sintaksës ose të fjalisë; - ta përvetësojnë funksionin e	- Emri në rasën emërore, kallëzore, gjinore, dhanore, rrjedhore - Emri në rasën kallëzore me parafjalë	- Emri si njësi morfosintaksore në fjali	- Ushtrime me tekste të zgjedhura, ku nxënësit gjejnë emrat dhe përcaktojnë trajtën, gjininë, numrin; i klasifikojnë ata në të përveçëm e të përgjithshëm, në konkretë e abstraktë dhe përvetësojnë funksionin e formave të emrit në fjali kur emri është në

emrit në fjali... (kundrinori i drejtë dhe i zhdrejtë).			trajtën e pashquar dhe në trajtën e shquar. Mjetet: Tekstet e gramatikës dhe librat e leximit, tekstet e shkruara në hamer nga arsimtari, grafoskopi dhe mjetet tjera audiovizuale. Format e punës janë të kombinuara.
- të aftësohen të përdorin drejt gjininë dhe numrin e emrave dhe mbiemrave me numrin dhe vetën e foljeve; - t'i përdorin drejt mbiemrat dhe përemrat pronorë me emrat e gjinisë mashkullore, në shumës, tema e të cilëve del me - e.	- Gjinia dhe numri i emrave dhe i mbiemrave	- Përshtatja e mbiemrave me emrat	- Ushtrime me tekste të ndryshme me emra mashkullore, femërorë dhe asnjans, me emra që në njëjës mbarojnë me bashkëtingëllore, me emra që në njëjës mbarojnë me zanore; Ushtrime për dallimin e gjinisë gramatikore dhe natyrore me emra në rasën gjinore, me mbiemra dhe me përemra pronorë.
- t'i përdorin drejt përemrat pronorë në bashkëvajtje me emrin nëpër rasi, në njëjës dhe në shumës; - të dallojnë përemrat pyetës dhe të pacaktuar, veçoritë gramatikore, funksionet dhe drejtshkrimin e tyre.	- Përemrat pronorë dhe të pacaktuar	- Përemrat pronorë dhe të pacaktuar	- Ushtrime për përdorimin e përemrave pronorë në bashkëvajtje me emrat, sidomos me emrat e gjinisë femërore në njëjës dhe në shumës. (nënës sime; nënën time; nëna jonë; nënës sonë; nënën tonë...).
- të dallojnë format, kuptimin dhe përdorimin e numërorëve.	- Numërori	- Emërzimi i numërorëve - Fjalë të parme, të përngjitura, të përbëra dhe lokucione	- Ushtrohen numërorët si numër, sasi, radhë, kohë të caktuara; ushtrohen për të dalluar emërimin e numërorëve me anë të prapashtesës – <b>shi</b> ; ushtrohen t'i dallojnë numërorët nga mbiemrat e formuar prej numërorëve.
<b>Kapitulli III: Folja nga aspekti morfosintaksor</b>			
- ta përvetësojnë klasifikimin e foljes në tri zgjedhime; - t'i dallojnë foljet të cilat kanë	- Klasifikimi i foljeve në zgjedhime -Foljet kalimtare dhe	- Zgjedhimi i foljeve -Foljet kalimtare dhe jokolimtare	- Ushtrime për zgjedhimin e foljeve, duke u ndalur në kategoritë gramatikore të tyre (në fletëzat e parapërgatitura gjendet folja dhe

<p>mundësi të përdoren me kundrinë të drejtë dhe me kundrinë të zhdrejtë;</p> <p>- të dallojnë temën, rrënjën, mbaresat, kohët e thjeshta dhe të përbëra.</p>	<p>jokalimtare</p> <p>- Format veprare dhe joveprare të foljes</p>	<p>- Format veprare dhe joveprare të foljes</p>	<p>përcaktohet koha, veta, numri i saj);</p> <p>Ushtrime për dallimin e foljeve veprare dhe joveprare...</p>
<p>- ta kuptojnë funksionin themelor të foljes në kohën e tashme, të shkuar dhe të ardhme, si dhe vlerat tjera që mund të marrin ato;</p> <p>- t'i përdorin drejt foljet në mënyrën lidhore me foljet modale ose gjysmëmodale: <i>mund, duhet, lipset, dëshiroj, dua, fillon, nis</i> etj. dhe lidhëzat nënrenditëse, të cilat përdoren me një folje në mënyrën lidhore, por pa ndonjë folje modale ose gjysmëmodale.</p>	<p>- Mënyra lidhore dhe kohët e saj</p>	<p>- Mënyra lidhore</p>	<p>- Ushtrime për përdorimin e foljes në të gjitha kohët e mënyrës lidhore.</p>
<p><b>Kapitulli IV: Funksionet gramatikore të fjalëve që lidhen me foljen</b></p>			
<p>- të mësojnë për funksionin gramatikor të kryefjalës dhe të kallëzuesit (cilat pjesë të ligjëratës e kryejnë funksionin e kryefjalës dhe në ç'formë?);</p> <p>- të mësojnë për kallëzuesin emëror dhe kallëzuesin foljor dhe për rendin e kryefjalës, të kallëzuesit dhe të pjesëve tjera të fjalisë.</p>	<p>- Kryefjala dhe kallëzuesi</p>	<p>- Kryefjala</p> <p>- Grupi emëror</p> <p>- Kallëzuesi emëror</p> <p>- Kallëzuesi foljor</p>	<p>- Ushtrime me tekste të ndryshme, duke nënvizuar gjymtyrët kryesore të fjalisë dhe duke përdorur pyetjet përkatëse për gjetjen më të lehtë të tyre.</p> <p>Si mjete mund të përdoren edhe libri i leximit, detyrat e dhëna në tekstin e gramatikës, grafoskopi dhe literatura tjetër ndihmëse...</p>
<p>- ta kuptojnë ndërtimin, vendin dhe rolin e kundrinorit në fjali dhe foljet kalimtare dhe jokalimtare të cilat e shprehin kundrinorin;</p>	<p>- Kundrinori i drejtë dhe kundrinori i zhdrejtë</p>	<p>- Grupi emëror me një emër</p> <p>- Grupi emëror me një përemër...</p>	<p>- Formulohen fjali me kundrinorë dhe përcaktohet lloji i tyre...</p>

<p>- ta kuptojnë funksionin e emrit në rasën kallëzore me dhe pa parafjalë si kundrinë e drejtë dhe si kundrinë e zhdrejtë dhe funksionin e emrit në rasën dhanore si kundrinë e zhdrejtë.</p>			
<p>- t'i dallojnë llojet, vendin, rolin e rrethorëve dhe funksionin e tyre si gjymtyrë të dyta të fjalisë; - ta bëjnë dallimin e rrethororit nga kundrinori i drejtë dhe i zhdrejtë pa parafjalë si plotës i fjalisë.</p>	<p>- Rrethorori</p>	<p>- Rrethorori</p>	<p>- Ushtrohet formulimi i pavarur i fjalive që përmbajnë në trupin e tyre gjymtyrë plotësuese – ushtrohet dallimi i rrethororit nga kundrinori i drejtë apo i zhdrejtë.</p>
<p>- të njihen me ndërtimin, përshtatjen dhe vendin e përcaktorit të shprehur me mbiemër, përemër e numëror; - të njihen me funksionin e përcaktorit në fjali, si dhe me tiparet e përcaktorit (të veçuar dhe të paveçuar).</p>	<p>- Përcaktori i shprehur me mbiemër, përemër dhe numëror</p>	<p>- Përcaktori</p>	<p>- Ushtrojnë dallimin e përcaktorit të shprehur me mbiemër, përemër a numëror. Përmes ushtrimeve njihen me funksionin e fjalëve në fjali...</p>
<p>- të njihen me ndërtimin dhe kuptimin e përcaktorit të shprehur me një emër i cili përcakton një grup emëror ose një emër të vetëm në fjalitë e nënrenditura përcaktore, me ose pa parafjalë; - t'i mësojnë format e grupit emëror si përcaktorë në rasa të ndryshme (Teatri i Shkupit; një thes kripë, punë nxënësish; pjesë nga romani; rrugët me pluhur etjl); - të bëjnë dallimin e formave të</p>	<p>- Përcaktori i shprehur me emër dhe me forma të pashtjelluara</p>	<p>- Format e emrave (format rasore - aloformat ose morfemat formëformuese) në funksion të përcaktorit - Format e pashtjelluara në funksion përcaktori</p>	<p>- Ushtrime për përdorimin e përcaktorit të shprehur me një emër që përcakton një grup emëror, në rasa të ndryshme me ose pa parafjalë, në fjalitë e nënrenditura përcaktore (njëkohësisht mund ta bëjnë edhe dallimin e pjesores si përcaktor në një fjali nga kuptimi i saj si formë e ngurosur që me ndihmën e foljeve ndihmëse JAM dhe KAM e shpreh kallëzuesin e një fjalie).</p>



pashtjelluara, si forma mënyrore nga format e pashtjelluara si përcaktorë: e kam mbështetur – mbështetur...			
- të njihen me ndajshtimin e veçuar dhe të paveçuar si gjymtyrë e dytë e fjalisë, i cili vihet pas emrit bërthamë ose pas një përemri.	- Ndajshtimi	- Ndajshtimi i veçuar - Ndajshtimi i paveçuar	- Ushtrohet ndajshtimi i shprehur me një emër në rasën emërore, bëhet dallimi i emrit si ndajshtim dhe emrit bërthamë të një qenieje, sendi apo dukurie; - Ushtrohet dallimi midis ndajshtimit të veçuar dhe të paveçuar...
<b>Kapitulli V: Klasat e fjalive</b>			
- të aftësohen ta bëjnë dallimin mes fjalisë së thjeshtë dhe fjalisë së përbërë me bashkërenditje dhe me nënrenditje; - të aftësohen t'i përdorin lidhëzat bashkërenditëse në fjalitë e përbëra bashkërenditëse dhe lidhëzat nënrenditëse në fjalitë e përbëra me nënrenditje.	- Fjalitë e përbërë	- Fjalitë e përbërë	- Ushtrime për dallimin dhe njohjen e strukturës së fjalive të thjeshta dhe të përbëra; - Ushtrime për fjalinë e thjeshtë me një tërësi ndërtimi dhe për fjalinë e përbërë me bashkërenditje me dy e më shumë tërësi strukturore që lidhen njëra me tjetrën; - Ushtrime për ndarjen e pjesëve të pavarura të fjalisë; - Ushtrime për lidhjen e fjalive me bashkërenditje me lidhëzën <b>dhe, ose</b> etj.
- të dallojnë lidhëzat <b>e, edhe, dhe, si dhe, jo vetëm, jo vetëm që, as, por as, kurse, megjithatë, veçse, prandaj</b> etj. nga lidhëzat me nënrenditje që lidhin dy elemente që kanë marrëdhënie varësie: <b>ku, nga, ngado që, për shkak se, në mënyrë që, ndonëse, edhe pse, edhe sikur</b> etj.	- Lidhëzat bashkërenditëse dhe funksioni i tyre në fjalitë me bashkërenditje	- Lidhëzat bashkërenditëse	- Ushtrime me shkrim për përdorimin e lidhëzave bashkërenditëse dhe nënrenditëse, duke e bërë dallimin e funksionit të tyre në fjalitë me bashkërenditje dhe me nënrenditje; - Ushtrime për zgjerimin e njohurive rreth përdorimit të lidhëzave, në mënyrë të veçantë për lidhëzat bashkërenditëse.
- t'i përdorin drejt lidhëzat: <b>dhe, e, edhe, as, as, por edhe</b> , ose te fjalitë mohore lidhëzat e	- Fjalitë me bashkërenditje	- Fjalitë shtuese ose këpujore	- Ushtrime për përdorimin e lidhëzave bashkërenditëse në fjalitë me bashkërenditje, duke i thelluar njohuritë për përdorimin e tyre

<p>bashkëlidhura: <b>jo vetëm që, por as</b> si elementë të strukturës në ndërtimin e fjalisë së dytë ku shprehet ngjyrimi i shkakut, i mospajtimit, i shkallëzimit etj.</p>			<p>në fjalitë me bashkërenditje shtuese ose këpujore.</p>
<p>- t'i përdorin drejt lidhëzat: <b>po, por, mirëpo, porse, kurse</b> si elementë të strukturës në ndërtimin e fjalisë së dytë ku shprehet ngjyrimi i përgjithshëm i kundërvënies ose i mospajtimit, apo kundërshtimit të pjesës së dytë të fjalisë me bashkërenditje.</p>	<p>- Fjalitë me bashkërenditje</p>	<p>- Fjalitë kundërshtore</p>	<p>- Ushtrime për përdorimin e lidhëzave bashkërenditëse në fjalitë me bashkërenditje ku në fjalinë e dytë shprehet ngjyrimi i kundërvënies apo i kundërshtimit ose shprehja e diçkaje që është e ndryshme nga ajo që pritej nga fjalia e parë.</p>
<p>- t'i përdorin drejt lidhëzat: <b>apo, o., a., ose., ja</b> si elementë të strukturës në ndërtimin e fjalisë së dytë që japin dy a më shumë dukuri, fakte, ngjarje, që përjashtojnë njëra-tjetrën...; - të kuptojnë se përjashtimi, kushti dhe supozimi lidhen ngushtë me njëri-tjetrin.</p>	<p>- Fjalitë me bashkërenditje</p>	<p>- Fjalitë veçuese</p>	<p>- Ushtrime për përdorimin e lidhëzave bashkërenditëse në fjalitë me bashkërenditje ku në fjalinë e dytë shprehet ngjyrimi i përjashtimit, i kushtit dhe i supozimit ku secili nga këto ngjyrimet shprehet me mjete të caktuara - lidhëza.</p>
<p>- t'i përdorin drejt lidhëzat: <b>andaj, prandaj, andaj, pa</b> si elementë të strukturës në ndërtimin e fjalisë së dytë me bashkërenditje të domosdoshme dygjymtyrëshe, ku fjalia e dytë shpreh diçka që del si rrjedhim, përfundim ose përmbyllje e brendisë së fjalisë së parë.</p>	<p>- Fjalitë me bashkërenditje</p>	<p>- Fjalitë përmbyllëse</p>	<p>- Ushtrime për përdorimin e lidhëzave bashkërenditëse në fjalitë me bashkërenditje ku në fjalinë e dytë shprehet rrjedhimi, përfundimi ose përmbyllja e brendisë së fjalisë së parë.</p>

FUSHA PROGRAMORE: LETËRSI DHE LEKTYRË (50 orë)			
Objektivat	Përmbajtjet	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
<b>Poezia</b>			
<b>Nxënësit:</b> - të fitojnë njohuri për epikën popullore (për këngët legjendare dhe historike; - të aftësohen të qëmtojnë njësi të epikës popullore.	<u>Epika popullore:</u> - këngët legjendare dhe historike si lloje të epikës popullore	- Epika popullore	- Diskutime për këngët historike dhe legjendare; - Kërkime dhe grumbullime të këngëve legjendare dhe historike në lokalitetin ku jetojnë nxënësit...
- të dallojnë poezinë lirike nga ajo epike; - të dallojnë ditirambin dhe poezinë refleksive nga llojet e tjera; - të dallojnë temen dhe motivin në poezitë refleksive; - të zhvillojnë aftësitë e të shprehurit dhe të zhvillojnë dashurinë ndaj atdheut, kombit, natyrës...	<u>Lirika dhe llojet e saj:</u> - ditirambi - poezia refleksive	- Ditirambi - Poezia refleksive	- Recitimi i poezive të zgjedhura të llojit të ditirambit; - Ushtrime rreth motivit, temës dhe idesë në poezinë refleksive.
- të aftësohen të dallojnë poezinë epiko-lirike nga llojet e tjera;	Llojet e poezisë epiko-lirike - romanca	- Romanca	- Diskutime rreth elementeve lirike dhe epike në romanca.
- të njihen me kompozicionin e poezisë lirike dhe me motivet e mundshme të saj...	- Kompozicioni i poezisë lirike - MOTIVI	- Kompozicioni - Motivi	- Ushtrime për përcaktimin e motiveve në poezinë lirike; - Krijimi i poezive lirike nga ana e nxënësve duke iu përmbajtur rregullave të kompozicionit të poezisë lirike.
- të kuptojnë ritmin si element kryesor të metrikës; - të dallojnë theksin dhe pushimin si elemente të ritmit...	Ritmi dhe elementet e ritmit: - pushimi - theksi	- Ritmi - Pushimi - Theksi	- Dëgjimi i recitimeve të poezive me një ritëm të theksuar; - Ushtrime për dallimin e ritmit, pushimit dhe theksit
- të njihen dhe t'i dallojnë mjetet	Elementet shprehëse	- Simboli	- Ushtrime për dallimin e mjeteve

shprehëse poetike; - të aftësohen të japin shembuj, të pavarur.	poetike: - simboli - gradacioni - ironia	- Gradacioni - Ironia	shprehëse: simboli, gradacioni, ironia...;
<b>Proza</b>			
- të dallojnë romanin aventurier dhe fantastiko-shkencor nga romanet e tjera; - të caktojnë temën dhe idenë e romaneve të lexuara në fjalë në mënyrë të pavarur	Llojet e gjinisë epike: - romani fantastiko-shkencor - romani aventurier	- Romani fantastiko-shkencor - Romani aventurier	-Ushtrime rreth përcaktimit të etapave të subjektit të një vepre (tregimi a romani) të lexuar; - Diskutime rreth romanit aventurier dhe fantastiko-shkencor; - Përshkrimi i brendshëm dhe i jashtëm i personazheve.
- të dallojnë legjendat dhe anekdotat në bazë të tematikës dhe personazhëve të tyre.	Llojet tjera epike: - legjenda - anekdota	- Legjenda - Anekdota	- Diskutime rreth legjendave dhe anekdotave dhe tematikës së tyre apo rolit të tyre edukativ; - Kërkime dhe grumbullime të legjendave dhe anekdotave në lokalitetin ku jetojnë nxënësit...
- të dallojnë subjektin si element kryesor të formës së tekstit letrar dhe të përcaktojnë etapat e subjektit.	- Subjekti i veprës letrare, etapat e subjektit...	- Etapat e subjektit	- Ushtrime dhe diskutime rreth etapave të subjektit...
<b>Drama</b>			
- t'i vërejnë në mënyrë të pavarur dhe të diskutojnë për strukturën e një vepre dramatike: akti, pamja, skena...	Struktura e krijimeve dramatike: - akti - pamja - skena	- Akti - Pamja - Skena	- Diskutime rreth aktit, pamjes dhe skenës; - Diskutime rreth një shfaqjeje teatrore.
- të dallojnë dramën në kuptimin e ngushtë të fjalës nga monodrama dhe nga llojet tjera...; - të nxisin dashurinë ndaj teksteve dramatike dhe për teatrin...	Llojet e dramës: - monodrama - drama në kuptimin e ngushtë të fjalës	- Monodrama	- Diskutime për veçoritë e tragjedisë dhe komedisë; - Ushtrime për dramatizim të teksteve...; - Pamja e një shfaqjeje teatrore...

<b>Llojet letraro-shkencore</b>			
- t'i dallojnë dhe të aftësohen të mbajnë ditar, të shkruajnë letër dhe autobiografi.	- Ditari, letra dhe autobiografia	- Ditari - Letra - Autobiografia	- Ushtrime për mbajtjen e ditarit; - Ushtrime për shkrimin e letrave dhe autobiografive...
<b>Lekyra</b>			
Gjatë vitit shkollor lexohen 8 lektyra			
- të fitojnë shprehje leximi të veprave të autorëve shqiptarë dhe të huaj; - të dinë të ritregojnë fabulën e lektyrave të lexuara; - ta përcaktojnë temën dhe idenë e krijimeve të lexuara poetike; - ta përcaktojnë narratorin, llojin dhe gjininë e veprës së lexuar letrare; - të aftësohen të diskutojnë e të shkruajnë për përmbajtjen e veprës së lexuar dhe për karakterin e personazheve...	- Lekyra (tituj të zgjedhur nga letërsia shqipe dhe ajo botërore)	- Lekyra	- Ushtrime për lexime dhe analiza me gojë dhe me shkrim të lektyrave sipas planeve të përgatitura paraprakisht nga arsimtari i lëndës (nxënësit ushtrojnë si dhe çfarë të shkruajnë në fletoret tyre – të përcaktojnë kohën dhe vendin e ngjarjeve, të dallojnë personazhet kryesorë nga ata të dorës së dytë, të thellohen në kundërvënien mes personazheve...)

<b>FUSHA PROGRAMORE: TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA (34 orë)</b>			
Format e të shprehurit: të shprehurit me gojë dhe të shprehurit me shkrim			
<b>Objektivat</b>	<b>Përmbajtjet</b>	<b>Konceptet</b>	<b>Veprimtaritë, metodat</b>
<b>I. Diskutimi</b>			
<b>Nxënësit:</b> - të aftësohen të diskutojnë për tema të ndryshme jetësore; - të përdorin drejt gjuhën letrare shqipe në të folur e në të	- Diskutimi	- Diskutimi	- Diskutime për tema që lidhen me sjelljen e nxënësve, pirjen e duhanit, veshjen, muzikën, filmat, emisionet e radios e të televizionit, gazetat e revistat...;

shkruar...			
<b>II. Të shprehurit tregues</b>			
- të aftësohen të tregojnë ngjarje të vërteta ose të imagjinuara duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse...	- Tregimi	- Tregimi	- Ushtrime për vlerësimin dhe seleksionimin e tregimeve të hartuara për t'u publikuar në këndin e letrarëve, revistat për fëmijë apo në gazetën e murit.
<b>III. Të shprehurit ritregues</b>			
- të aftësohen për të ritreguar ngjarje duke u kujdesur për rendin kronologjik të gjërave; - të thellojnë aftësitë për të ritreguar me ndryshim të kohëve të foljeve; - të japin gjykimet personale lidhur me shfaqjet teatrore dhe filmat e shikuar, lidhur me ndeshjet sportive, lidhur me përmbajtjet e veprave të lexuara letrare...	- Ritregimi	- Ritregimi	- Ritregohen gazmore dhe përmes garës zgjedhen interpretuesit (aktorët) më të mirë dhe gazmoret më interesante; - Ushtrime për të ritreguar tekste të dhëna me ndryshim të kohëve të foljeve.
<b>IV. Të shprehurit përshkrues</b>			
- të thellojnë aftësitë për të përshkruar peizazhe, monumente kulture dhe personazhë letrarë...; - të dallojnë të shprehurit përshkrues nga të shprehurit tregues; - të aftësohen të vazhdojnë tekstet me fillim ose me fund të dhënë...	- Përshkrimi	- Përshkrimi	- Ushtrimet për përshkrimin e peizazheve, monumenteve të kulturës, personazhëve letrarë...; - Ushtrime për të portretizuar prindërit, shokët, miqtë, të njohurit, njerëzit e profesioneve të ndryshme - sportistët, këngëtarët, aktorët...

<b>V. Të shprehurit me shkrim për qëllime praktike dhe nevoja personale</b>			
- të aftësohen të mbajnë procesverbale duke shënuar pikat më të rëndësishme të rrjedhës së një mbledhjeje;	- Procesverbali	- Procesverbali	- Ushtrime për shkrimin e procesverbaleve sipas modeleve të zgjedhura nga arsimtari...
<b>VI. Hartimet me shkrim</b>			
- të aftësohen të shkruajnë hartime të bukura, duke i dhënë krah imagjinatës dhe kreativitetit...	- Gjatë vitit bëhen 3 hartime me shkrim (një në gjysmëvjetorin e parë dhe dy në gjysmëvjetorin e dytë)	- Hartimi	- Ushtrime parapërgatitore lidhur me përmbajtjen, kompozicionin, stilin e të shprehurit, drejtshkrimin dhe pamjen e jashtme të hartimit...

<b>FUSHA PROGRAMORE: KULTURA E MEDIAS (10 orë)</b>			
<b>Objektivat</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Konceptet</b>	<b>Veprimtaritë dhe metodat</b>
<b>Nxenesit:</b> - të njihen me filmin artistik dhe llojet e tij; - të aftësohen të dallojnë veçoritë e filmit artistik; - të aftësohen të krahasojnë filmin artistik me një vepër letrare...	- Filmi artistik	- Filmi artistik	- Lexojnë në klasë matetrialetë të botuara që ofrojnë të dhëna mbi filmin dhe llojet e tij...
- të njihet me llojet e emisioneve të ndryshme televizive; - të bëjnë dallimin mes emisioneve televizive dhe atyre të radios; - ta kuptojnë rolin që ka sot TV në jetën e përditshme dhe atë shoqërore...	- Emisionet televizive	- Emisionet televizive	- Shohin bashkë emisione televizive dhe debatojnë rreth tyre; - Krahasojnë emisionet televizive me ato të radios dhe mediave të tjera...

<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njihen me radion dhe mënyrën e funksionimit të këtij mediumi;</li> <li>- të njihen me llojet e radio-emisioneve;</li> <li>- të dallojnë mjetet shprehëse të radios;</li> <li>- ta kuptojnë rolin edukativ e shoqëror të radios në jetën e njerëzve;</li> <li>- të njihen me historinë e radios...</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Radioja</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Radioja</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vizitojnë studion e ndonjë radioje dhe njihen me rëndësinë e këtij mediumi dhe me mënyrën e funksionimit...</li> </ul>
--	---	---	---

### 3. UDHËZIME DIDAKTIKE

Programi mësimor i lëndës *Gjuhë shqipe dhe letërsi* është përgatitur sipas kërkesave dhe metodave bashkëkohore, duke respektuar parimin e bashkëlidhjes (korelacionit) dhe integritit të të gjitha fushave programore, në veçanti të fushave programore **Gjuhë dhe Letërsi**. Përmbajtjet e lëndës *Gjuhë shqipe dhe letërsi* (VII-IX) realizohen me anën e të dëgjuarit, të kuptuarit dhe të shprehurit (me gojë dhe me shkrim) të temave nga jeta e përditshme; me anën e të lexuarit dhe analizës së teksteve nga letërsia popullore dhe e shkruar, si dhe të teksteve me përmbajtje shkencore-popullarizuese dhe informative nga libri i leximit, revistat dhe nga burimet tjera.



Në përmbajtjet e zgjedhura duhet të mbizotërojnë temat e mirësjelljes, të shoqërimit, të dashurisë, të punës, të gëzimeve të jetës, të paqes e lirisë, të bukurive të natyrës, të kujdesit ndaj ambientit jetësor etj.

Të gjitha përmbajtjet e lëndës *Gjuhë shqipe dhe letërsi* duhet të jenë në bashkëlidhje me përmbajtjet e lëndëve të tjera: me *gjuhën e huaj* (me qëllim të përvetësimit më të lehtë të terminologjisë, ligjeve dhe rregullave gramatikore të të dy gjuhëve); me lëndën e *historisë* (me qëllim të njohjes me zhvillimin historik të gjuhës, kur analizojnë, fjala vjen, këngë nga cikli i Gjergj Kastriotit, si figurë historike dhe si personazh letrar); me lëndën e *gjeografisë* (me qëllim të njohjes me dialektet e gjuhës shqipe); me *artin figurativ* (me qëllim të paraqitjes figurative të ngjarjeve dhe personazheve të teksteve të interpretuara letrare); me *artin muzikor* (me qëllim të përvetësimit më të mirë të njohurive mbi ritmin, rimën, figurat gjuhësore - asonancën dhe aliteracionin etj.).

Fusha programore *Letërsia dhe lektyra* zë vendin kryesor në mësimdhënien e lëndës *Gjuhë shqipe dhe letërsi* dhe realizohet me leximin dhe përshkrimin e teksteve poetike, epike dhe dramatike, por dhe të teksteve me karakter fantastiko-shkencor dhe informativ, duke pasur gjithnjë parasysh rritjen e shkallëshkallshme të nivelit të njohurive të nxënësve...

Fusha programore *Gjuhë* nuk përfshin vetëm çështjen e përvetësimit formal të gramatikës e të ligjshmërive të saj, të drejtshkrimit e të drejtshqiptimit, sepse zotërimi i gramatikës funksionale vihet edhe në funksion të fushave programore *Të shprehurit dhe krijimtaria*, dhe *Kultura e medias*, duke përbërë kështu një tërësi të pandashme gjatë realizimit të procesit edukativo-arsimor.

Përmbajtjet e të gjitha fushave programore burojnë nga tekstet (artistike, gazetareske, shkencore, fantastiko-shkencore...) që shërbejnë si modele për krijimin e teksteve të reja nga nxënësit dhe japin mundësi për realizimin e të shprehurit dhe krijimtarisë (me gojë e me shkrim) në mënyrë sa më të pavarur, sa më origjinale e sa më funksionale.

Gjatë përgatitjes së planeve të punës arsimitari duhet t'i ketë parasysh kushtet që ofron shkolla (mjetet dhe pajisjet mësimore që ka në disponim) për realizimin e procesit mësimor, të përllogarisë me kujdes kohën e nevojshme (numrin e orëve) për arritjen e objektivave të caktuar dhe të përdorë metodat dhe teknikat bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies që do t'ia mundësojnë mbylljen e suksesshme të vitit shkollor.

### **Fushat programore:**

- Gjuhë – 50 orë
- Letërsi dhe lektyrë – 50 orë
- Të shprehurit dhe krijimtaria – 34 orë
- Kultura e medias – 10 orë

Fushat programore realizohen gjatë tërë vitit shkollor të ndërlidhura, duke plotësuar njëra-tjetrën.

Nga fondi i përgjithshëm i orëve të parashikuara sipas fushave programore mund të bëhen shmangie të vogla në pajtim me veçantitë e mjedisit ku ndodhet shkolla dhe nevojat individuale të nxënësve. Po kështu, lejohen edhe disa shmangie që kanë të bëjnë me

dendurinë e objektivave, përmbajtjeve dhe veprimtarive konkrete. Pra: numri i orëve mund të përshtatet (gjer në një shkallë të arsyeshme...) me nevojat e shkollës së caktuar (mjedisit jetësor prej nga vijnë nxënësit, statusit të tyre kulturor-shoqëror dhe arsimor, përgatitjeve paraprake të nxënësve).

#### **- Qasja e individualizuar ndaj punës edukativo-arsimore**

Në bazë të njohurive shkencore për dallimet në zhvillimin e fëmijëve, është e nevojshme të bëhet përshtatja e mësimdhënies me zhvillimin dhe me nevojat e arritjet individuale të nxënësve. Me fjalë të tjera, nevojitet zbatimi i teknikave dhe strategjive që i kërkon **qasja e individualizuar** me detyra të diferencuara gjatë realizimit të punës edukativo-arsimore me nxënësit. Në këtë mënyrë mund të arrihen më së miri standardet e përcaktuara në fund të ciklit të tretë të shkollës fillore nëntëvjeçare.

#### **- Përfshirja e prindërve në veprimtarinë e mësimdhënies**

Familja është shkolla e parë për nxënësit dhe një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e tyre. Prandaj, gjatë realizimit të objektivave, përmbajtjeve dhe veprimtarive në lëndën *Gjuhë shqipe dhe letërsi* duhet të sigurohet **komunikimi bashkëpunues me prindërit e nxënësve dhe përfshirja e tyre në punën e shkollës**, në funksion të: zhvillimit dhe përkrahjes së marrëdhënieve prind - nxënës; kultivimit dhe zhvillimit të kulturës së të folurit në familje; realizimit të disa objektivave dhe përmbajtjeve të programit dhe të organizimeve letrare në kuadër të shkollës; informimit të prindërve; këmbimit të përvojave sa u përket specifikave të nxënësit dhe veprimeve ndaj tij etj.

#### **- Mjetet mësimore**

- Për realizimin e mësimdhënies së lëndës *Gjuhë shqipe dhe letërsi*, përveç tekstit themelor, të lejuar nga ministri i arsimit dhe shkencës, këshillohet shfrytëzimi i ***doracakëve të ndryshëm, fletoreve të punës, librit të gjuhës***, të udhëzuesve metodikë për realizimin e mësimdhënies dhe të veprimtarisë edukativo-arsimore...
- **Burimet e të mësuarit në mjedisin e afërt:** resurset e mjedisit që do të vëzhgohen e do të përshkruhen, objekte me karakter kulturor, edukativ, publik dhe shërbyes (dyqan, kinema, teatër, muze, park nacional, bibliotekë, stacion autobusësh etj.), situata me komunikime të ndryshme mes njerëzve në shkollë, në familje dhe në rrethin jetësor.
- **Enciklopedi dhe fjalorë shpjegues** të ndryshëm.
- **Softuerë arsimorë kompjuterikë** për pasurimin e kulturës së të folurit e të kulturës gjuhësore – ***programi toolkid dhe CD-ROM-a të tjerë multimedialë të verifikuar*** me lojëra edukative përkatëse – të verifikuara nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të RM-së.
- **Revista të përshtatshme për moshën e nxënësve**, të verifikuara e të miratuara nga MASH.

- **Krijime letrare** nga autorë të njohur shqiptarë e të huaj (që për nga përmbajtja dhe vlera estetike i përgjigjen moshës së nxënësve)
- **Mjete audio-vizuale, auditive, vizuale dhe mjete të tjera me veti kinetike** – programe televizive, emisione me karakter edukativ, filma të animuar dhe artistikë; videokaseta, disqe të DVD e CD-së me filma të animuar e me filma artistikë dhe me tekste të letërsisë popullore dhe artistike, me ngjarje të regjistruara, ditëlindje, me shfaqje teatrore etj.; audiokaseta me zëra të inçizuar, emisione lajmesh, tekste të lexuara në mënyrë artistike; aplikacione, ilustrime, makete; skena teatrore; sende të lëvizshme me efekte akustike dhe sende të tjera sipas nevojave që kërkon mësimdhënia e kësaj lënde.

#### **4. VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE**

##### *NOTIMI DHE KONTROLLIMI DIAGNOSTIK*

Në fillim të vitit mësimor arsimtari bën notim dhe kontrollim diagnostik, me qëllim të verifikimit të njohurive dhe aftësive të nxënësve të fituara përgjatë vitit shkollor pararendës. Arsimtari mund ta realizojë këtë me ndihmën e instrumenteve të ndryshme: përmes testeve diagnostike, përmes fletëzave anketuese, përmes pyetjeve gojore të përgatitura e të mirëmenduara nga ana e tij, përmes shkrimit të teksteve të shkurta etj.

Rezultatet e fituara paraqesin pasqyrën e njohurive dhe aftësive konkrete të nxënësve dhe si të tilla shërbejnë edhe si pikënisje për planet e mëpastajme për realizimin e Programit mësimor dhe përparimin e procesit kompleks të vlerësimit gjatë vitit shkollor.

##### *NOTIMI FORMATIV*

Gjatë kl. VIII preferohet edhe vlerësimi formativ që mundëson notimin më objektiv të arritjeve të nxënësve gjatë një periudhe të caktuar. Këtë tip notimi arsimtari mund ta realizojë me shfrytëzimin e më shumë metodave të notimit:

- bisedave mes nxënësit dhe arsimtarit;
- prezentimeve gojore;
- hartimeve me shkrim;
- testeve;
- detyrave të shtëpisë.
- portfolieve – mbledhjes së treguesve për arritjet e secilit nxënës, siç mund të jenë krijimeve origjinale të nxënësve...

Portfoliet duhet të jenë të njohura për prindërit e nxënësve që edhe ata të mund të kontribuojnë në realizimin sa më të mirë të mësimin të lëndës *Gjuhë shqipe dhe letërsi*.

Portfoliet e nxënësit plotësohen me të dhëna gjatë viteve të ardhshme shkollore.

Këto metoda të notimit arsimtari mund t'i vlerësojë dhe t'i kontrollojë me lista të veçanta të evaluimit për çdo nxënës, të përgatitura paraprakisht, të cilat plotësohen me çdo aktivitet konkret. Rezultatet e fituara të arritjeve të nxënësve janë të arritshme për arsimtarët, nxënësit dhe prindërit e tyre.

#### *NOTIMI MIKROSUMATIV*

Ky lloj notimi praktikohet në fund të çdo tremujori. Ai mbështetet në notimin formativ dhe prej rezultateve të arritura formohen notat e një tremujori për arritjet e nxënësve.

#### *NOTIMI SUMATIV*

Në bazë të të dhënave të tërësishme të fituara nga ndjekja dhe kontrollimi i të arriturave të nxënësve gjatë periudhës së realizimit të Programit mësimor, arsimtari e konstaton përparimin e çdo nxënësi veç e veç, në kuadër të secilës fushë programore. Nga notat e formuara sumative, të formuluar për çdo nxënës, duke u udhëhequr gjithnjë nga nivelet e arritjeve, gjatë një periudhe të caktuar kohore, arsimtari vendos notat përkatëse numerike.

## **5. KUSHTET HAPËSINORE**

Mjedisi i mësimdhënies (klasa etj.) duhet t'i ketë kushtet themelore për zhvillimin normal dhe aktiv të veprimtarisë mësimore. Orenditë e klasës të mund të zhvendosen me lehtësi për t'u përshtatur me aktivitetet dhe format e punës si dhe të mundësojnë komunikim aktiv dhe pa pengesa në relacionin nxënës-nxënës, nxënës-mësimdhënës. Klasa duhet të ketë këndin e bibliotekës, këndin për lojë dhe këndin për ekspozita dhe aktivitete të tjera. Kushtet hapësinore duhet të jenë në përputhje me Normativin për kushtet hapësinore të miratuar nga ana e ministrit të arsimit dhe shkencës me vendimin nr. 07-4061/1 të datës 31.05.2007.

## **6. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR**

Realizimin e programit mësimor për klasat VII – IX parashikohet ta bëjë mësimpldhënësi që ka kryer shkollimin e lartë adekuat që është përcaktuar me Ligjin për arsimin fillor.

## **7. KOMISIONI QË PËRGATITI PROGRAMIN MËSIMOR**

- Fatmir Sulejmani - këshilltar pedagogjik – (*koordinues*)
- Prof. dr. Qani Memeti - Fakulteti Filologjik, Shkup
- Mujdin Sulejmani - Shkolla fillore “Rilindja”, Sellcë
- Emine Muaremi - Shkolla fillore “Përparimi”, Reçicë e Madhe
- Prof. dr. Zeqir Kadriu - UEJL, Tetovë

